REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KESHILLI BASHKIAK LUSHNJE

Nr_____ **Lushnje me ____/____/2026**

PROCESVERBAL

ORA:13:00-:14:00
Lloji i mbledhjes:E hapur, e radhes.
Drejtuesi i mbledhjes:Erjet Dhima

I mbajtur sot me date 22.01.2026 mbi zhvillimin e mbledhjes se keshillit bashkiak Lushnje me kete rend dite:

1-Miratimi i rendit te ditës.

2-Projekt –Vendim: Për miratimin e fondit për familjet në nevojë që do te trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe ato që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor per muajin **Dhjetor** 2025 .
3-Projekt–Vendim: Per miratimin e kritereve që do te ndiqen për familjet në nevojë që do te trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe ato që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor per vitin 2026.
4-Projekt–Vendim:Për miratimin e listës së subvencionimit të qirasë për familjet e pastreha ,që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të perballuar vetë të gjithë vlerën e qirasë.
5-Projekt–Vendim:Për miratimin e investimit , sistemimin e dy shesheve të pallateve përgjatë rrugës"Besim Nuri" lagjja 'Kongresi i Lushnjes".
6-Projekt–Vendim:Për dhënien e autorizimit për rinovimin e kontratës së qirasë.
7-Projekt–Vendim: Për miratimin e prishjes së objektit garazhd të ish gjendja civile ,lagjja "Xhevdet Nepravishta",Bashkia Lushnje.
8-Projekt–Vendim: Mbi shpërblimin e sportistit Laurenc Hasko dhe trajnerit të tij Amarildo Gjyla.
9-Projekt–Vendim: Mbi shpërblimin e sportistes Gea Dokollari dhe trajnerit të saj Amarildo Gjyla.
10-Projekt–Vendim:Për miratimin e marrjes me qira të një ambienti të perkohshëm për Njesinë Administrative Krutje.
11-Projekt–Vendim:Për shpërblimin e ekipit të Lushnjes për femra dhe trajneres Erilda Allkanjari.
12-Projekt–Vendim:Për regjistrimin e trojeve të dhëna per ndërtim nga njesia e qeverisjes vendore,te cilat kane mbetur pa u regjistruar ne D.V.A.SH. Lushnje.

13-Projekt–Vendim:Per nje ndryshim ne V.K.B-ne nr.121 date 23.12.2025"Për miratimin e nivelit te pagave te punonjësve te bashkisë Lushnje,institucioneve në vartësi dhe të njesive administrative per vitin 2026".
14-Projekt–Vendim:Për një shtesë në buxhetin e vitit 2026,nga te ardhurat e trashëguara ,miratuar me me V.K.B-në nr. 122 datë 23.12.2025.
15-Projekt–Vendim:Për një shtesë në buxhetin e vitit 2026 nga granti i bazuar në performancë, ,trashëguar nga viti 2025 ,miratuar me V.K.B-në nr. 122 datë 23.12.2025.
16-Projekt–Vendim:Për disa ndryshime në V.K.B-në .nr 114 date 21.11.2025"Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore,administrimin e tyre në Bashkine Lushnje dhe penalitetet për kundravajtje administrative.
17-Projekt–Vendim:Për miratimin e planit te aktiviteteve të këshillit bashkiak Lushnje per vitin 2026.
18-Informacion:Per nxjerrjen jashte perdorimit te aktiveve per vitin 2025.

19-Miratimi i proçesverbalit.

MARRIN PJESE NE MBLEDHJE : 29 Keshilltare , Kryetarja e bashkise ,Drejtoret perkates.

Ergest Krakulli,Pirro Kallajxhiu,Merjeme Dervishi,Erjet Dhima,Elona Cani,Arianit Muco ,Ariola Koxha,Ledio Gjyla,Denisa Topi,Alban Toli,Rozeta Asanbejlli,Nadire Hoxha,Talibe Cela,Ervin Sina,Valdete Rrasa,Romina Allkanjari,Lediona Korreshi,Luciano Çela,Klement Çela,Ardit Sinani,Shkenca Arapi,Alvin Gjata,Ervis Pajolli,Kozeta Guci,,Besarta Veshi,Vojsava Bushi,Ardit Bali,Ilir Marku,Erion Bano.

-Flet: <u>Kryetari i keshillit Erjet Dhima</u>

- Pershendetje te gjitheve.Fillojme me mbledhjen e Keshillit bashkiak per muajin Janar 2026 .Kryetari lexon rendin e dites. Kalon per miratim pika e pare .**"Mbi miratimin rendit te dites".** Kuorumin e kemi 28 keshilltare

I jepet fjala Kryetares se Bashkise

Propozoj te shtohet ne rend dite edhe nje material Projekt akti nr 17 date 21.01.2026"Per miratimin e prishjes se objektit mulli ne fshatin Garunjas Nj Administrative Ballagat Bashkia Lushnje". Kjo shtese kalon si pike e 18-te ,pika e 18-te kalon si pike e 19-te dhe pika e 19-te kalon si pike e 20-te .

Hidhet ne votim rendi i dites bashke me shtesen e propozuar nga Kryetarja e bashkise.
-Miratohet me 28 vota pro ,0 kunder ,0 abstenim.

-Kalohet per shqyrtim **pika e dyte** e rendit te dites te mbledhjes se Keshillit Bashkiak Lushnje te dates 22.01.2026; Për miratimin e fondit për familjet në nevojë që do te trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe ato që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor per muajin **Dhjetor** 2025 .

Nuk ka diskutime.

-Hidhet ne votim ky material.

-Miratohet me 28 vota pro 0 kunder ,0 abstenim .

-Vendim: Për miratimin e fondit për familjet në nevojë që do te trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe ato që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor per muajin **Dhjetor** 2025 .

-Kalohet per shqyrtim <u>pika e trete</u> e rendit te dites te mbledhjes se Keshillit Bashkiak Lushnje te dates 22.01.2026; Per miratimin e kritereve që do te ndiqen për familjet në nevojë që do te trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe ato që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor per vitin 2026.

-Fjala i jepet Klement Çela
Ketu jane pasqyruar te gjitha kriteret ?

-Fjala i jepet Anila Çela
Kriteret tona jane sipas zones pasi nuk mund ti kemi njesoj kriteret si ne Diber.Lushnja ka specifika te tjera

-Hidhet ne votim ky material.

-Miratohet me 28 vota pro , kunder , abstenim .

-Vendim: Per miratimin e kritereve që do te ndiqen për familjet në nevojë që do te trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe ato që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor per vitin 2026.

Shenim:Hyn ne sallle keshilltari Alvin Gjata.

-Kalohet per shqyrtim <u>pika e katert</u> e rendit te dites te mbledhjes se Keshillit Bashkiak Lushnje te dates 22.01.2026; Për miratimin e listës së subvencionimit të qirasë për familjet e pastreha ,që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të perballuar vetë të gjithë vlerën e qirasë.

-Fjala i jepet Kryetares se bashkise

-Ne muajin Dhjetor hapen thirrjet .Kush aplikon deri ne Dhjetor do te shpallet fitues .Kush aplikon me vone do te perfitoje vetem nga buxheti vendor .Kjo liste do ti kaloj edhe Ministrise se Financave

-Hidhet ne votim ky material.

-Miratohet me 29 vota pro, 0 kunder , 0 abstenim.

-Vendim: Për miratimin e listës së subvencionimit të qirasë për familjet e pastreha ,që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të perballuar vetë të gjithë vlerën e qirasë.

-Kalohet per shqyrtim <u>pika e pese</u> e rendit te dites te mbledhjes se Keshillit Bashkiak Lushnje te dates 22.01.2026: Për miratimin e investimit , sistemimin e dy shesheve të pallateve përgjatë rrugës"Besim Nuri" lagjja 'Kongresi i Lushnjes".

-Fjala i jepet Kryetares se bashkise

Vitin e kaluar miratuam disa plane ,dhe kami bere aplikime prane Ministrise se Pushtetit Vendor .Jemi shpallur fitues me 7 ml leke..Ne propozojme qe ky grant te shkoj per sistemimin e ketyre dy shesheve.

-Fjala i jepet Klement Çela

Kam pare nga afer investimin te rruga"Ahmet Shabani".Problemi ishte afati i punimeve qe kishte kaluar Tetor 2025.Tjeter problematike trotuari.Duhet zgjeruar.Atje ku nuk duhet trotuari ka trotuar atje ku duhet nuk ka .

Fjala i jepet Kryetares se bashkise

Do te shkoj ta verifikoj vete kete problematike .Per sa i perkete afateve ka te beje me kushtet klimatike dhe problematika gjate investimit.

-Fjala i jepet Klement Çela

Tjeter problem pallati te Torre Spanja .Banoret kerkojne qe te shtrohet ai segment rruge.

Fjala i jepet Kryetares se bashkise

Ai segment duhet te ishte bere nga ivestitoret.Eshte parashikuar te lista e rrugeve qe do te behen me beton.

Fjala i jepet Ilir Marku

Edhe rruga Ahmet Shabani ka nevoje qe te kerkohet me shume llogari te binvestimi qe po behet.

Fjala i jepet Kryetares se bashkise

Kjo eshte nje rruge ne proces.Do ta shikojme por eshte ne proces.

-Fjala i jepet Klement Çela

Te shkolla "Skender Libohova"ka problem me energjine.Nuk mbajne automatet.Kaldaja eshte jashte funksionit.Duhet zgjidhje per femijet.Duhet pare dhe sistemi elektrik.

-Fjala i jepet Muarrem Sharka

Rrjeti ka ngarkesa nga kondicioneret.Nderhyrje ka patur .Kaldaja ka qene ne fuksion.Ne kemi bere cfare kemi mundur .

-Fjala i jepet Kozeta Guci

Shkolla "Vath Korreshi" dhe "Jani Nushi"kane probleme me ngrohjen .Ajo eshte ndezur vetem nje dite.

-Fjala i jepet Muarrem Sharka

Ka patur nje difekt por tani eshte ne rregull.

-Fjala i jepet Talibe Celes

Probleme ka dhe shkola ime .Eshte shume keq.

-Hidhet ne votim ky material.

-Miratohet me 29 vota pro , 0 kunder , abstenim .

-Vendim: Për miratimin e investimit , sistemimin e dy shesheve të pallateve përgjatë rrugës"Besim Nuri" lagjja 'Kongresi i Lushnjes".

-Kalohet per shqyrtim **pika e gjashte** e rendit te dites te mbledhjes se Keshillit Bashkiak Lushnje te dates 22.01.2026 **:** Për dhënien e autorizimit për rinovimin e kontratës së qirasë.

-Fjala i jepet kryetares se bashkise.
Behet fjale per rinovimin e marreveshjes qe lidhin Bashkite e qarkut .Asaj marreveshje i ka mbaruar afati dhe propozoj per rinovim.

--Fjala i jepet Klement Çela
Ne lidhje me shpenzimet nuk kemi informacion.Na eshte thene qe do ti kemi keto te dhena ,landfilldin e menaxhon bashkia e Fierit.

-Fjala i jepet Juliana Hasalla
Nuk kalon 15 ML sa ka celur Ministria.
-Fjala i jepet Alvin Gjata
A ka fond per shtimin e koshave ne fshatra?
-Fjala i jepet kryetares se bashkise.
Ne Fiershegan ka rreth 3 kosha shtese.Ne cojme atje ku eshte i aksesueshem kalimi nga mjeti teknologjik .Nese ka kerkesa do ta shohim hap pas hapi.
-Hidhet ne votim ky material .

-Miratohet me 29 vota pro ,0 kunder, 9 abstenim .

Vendim: Për dhënien e autorizimit për rinovimin e kontratës së qirasë.

Shenim:Keshilltari Ledio Gjyla del nga salla.

-Kalohet per shqyrtim <u>pika e shtate</u> e rendit te dites te mbledhjes se Keshillit Bashkiak Lushnje te dates 22.01.2026: **:** Për miratimin e prishjes së objektit garazhd të ish gjendja civile ,lagjja ”Xhevdet Nepravishta”,Bashkia Lushnje.

-Fjala i jepet Kryetares se bashkise.
Eshte nje garazhd te ish gjendja civile lagja “Xhevdet Nepravishta”.Eshte nje ngarazhd i vjeter tejet i amortizuar .Duhet te hapim nje hapesire per investimin e ri qe po behet aty.

-Hidhet ne votim ky material .

-Miratohet me 28 vota pro ,0 kunder, 0abstenim

-Vendim: : Për miratimin e prishjes së objektit garazhd të ish gjendja civile ,lagjja ”Xhevdet Nepravishta”,Bashkia Lushnje.

-Kalohet per shqyrtim <u>pika e tete</u> e rendit te dites te mbledhjes se Keshillit Bashkiak Lushnje te dates 22.01.2026 : Mbi shpërblimin e sportistit Laurenc Hasko dhe trajnerit të tij Amarildo Gjyla.

-Fjala i jepet Pirro Kallajxhiut.

-Dua te theksoj se jam pro ketyre shperblimeve ,po une propozoj ti vendosim rroge. Dy sportistes nisen per ne Bullgari.Keta jane sportiste te nivelit te larte.Shpenzimet i heq federate por jane te ekipit te Lushnjes.

-Fjala i jepet Kryetares se bashkise

-Sportistet do te punesohen dhe do te jene pjese e Klubit shume sportesh.Natyrisht ata qe kane dhe moshen e duhur.

-Fjala i jepet Bedri Hida

Propozoj qe te ndryshoj termi te Shtohet "Mbi perdorimin e fondit rezerve" dhe te hiqet neni 54 shkronja "n" dhe te shtohet udhezimi nr 9 pika 132 -135 i Ministrise Financave.Kjo vlen edhe per dy pikat e tjera te ngjashme.

-Fjala i jepet Erion Bano

Ne lidhje me punesimin dhe VKM-ja perkates e thote qe pjesen financiare e mbulon pushteti lokal.

-Hidhet ne votim ky material bashke me propozimin e Drejtorise Juridike.

-Miratohet me 28 vota pro , 0 kunder, 0 abstenim .

-Vendim: Mbi perdorimin e fondit rezerve per shpërblimin e sportistit Laurenc Hasko dhe trajnerit të tij Amarildo Gjyla.

-Kalohet per shqyrtim <u>pika e nente</u> e rendit te dites te mbledhjes se Keshillit Bashkiak Lushnje te dates 22.01.2026: Mbi shpërblimin e sportistes Gea Dokollari dhe trajnerit të saj Amarildo Gjyla.

-Nuk ka diskutime.

-Hidhet ne votim ky material me ndryshimet si pika e 8-te.

-Miratohet me 28 vota pro , 0 kunder , 0 abstenim .

-Vendim: Mbi perdorimin e fondit rezerve per shpërblimin e sportistes Gea Dokollari dhe trajnerit të saj Amarildo Gjyla.

-Kalohet per shqyrtim <u>pika e dhjete</u> e rendit te dites te mbledhjes se Keshillit Bashkiak Lushnje te dates 22.01.2026: Për miratimin e marrjes me qira të një ambienti të perkohshëm për Njesinë Administrative Krutje.

-Fjala i jepet Klement Çela.
-Kam nje pyetje.Nuk ka asnje institucion tjeter per ta shfrytezuar pa pagese per Njesine?
-Fjala i jepet Kryetares se bashkise.
Jo nuk ka asnje objekt shteteror .

-Hidhet ne votim ky material .

-Miratohet me 28 vota pro , 0 kunder 0 abstenim

-Vendim: Për miratimin e marrjes me qira të një ambienti të perkohshëm për Njesinë Administrative Krutje.

-**Kalohet per shqyrtim pika e njembedhjete** e rendit te dites te mbledhjes se Keshillit Bashkiak Lushnje te dates 22.01.2026 **:** Për shpërblimin e ekipit të Lushnjes për femra dhe trajneres Erilda Allkanjari.

-Fjala i jepet Klement Çela.
A ka ndonje kerkese per kete se ne relacion thote kerkese nga Federata.

Nuk ka diskutime te tjera.

-Hidhet ne votim ky material .

-**Miratohet me 28 vota pro , 0 kunder 0 abstenim**

-Vendim: Për shpërblimin e ekipit të Lushnjes për femra dhe trajneres Erilda Allkanjari.

Kalohet per shqyrtim pika e dymbedhjete e rendit te dites te mbledhjes se Keshillit Bashkiak Lushnje te dates 22.01.2026. Për regjistrimin e trojeve të dhëna per ndërtim nga njesia e qeverisjes vendore,te cilat kane mbetur pa u regjistruar ne D.V.A.SH. Lushnje

Fjala i jepet Bedri Hida

Ketu propozoj te hiqet neni 54 i ligjit 139 /2015.

Keshilltari Ergest Krakulli del nga salla pasi ka konflikt interesi ne kete pike .

Hidhet ne votim bashke me propozimin e Drejtorise Juridike .

Miratohet me 27 vota pro ,0 kunder 0 abstenim.

-Vendim: Për regjistrimin e trojeve të dhëna per ndërtim nga njesia e qeverisjes vendore,te cilat kane mbetur pa u regjistruar ne D.V.A.SH. Lushnje

Shenim Kthehet ne salle Ergest Krakulli.

-Kalohet per shqyrtim <u>pika e trembedhjete</u> e rendit te dites te mbledhjes se Keshillit Bashkiak Lushnje te dates 22.01.2026 : Per nje ndryshim ne V.K.B-ne nr .121 date 23.12.2025"Për miratimin e nivelit te pagave te punonjësve te bashkisë Lushnje,institucioneve në vartësi dhe të njesive administrative per vitin 2026".

Fjala i jepet Erisa Qalliu

Ky projekt akt eshte ne zbatim te VKM-se se dale per pagat minimale.

Hidhet ne votim ky material

Miratohet me 28 vota pro,0 kunder , 0 abstenim.

-Vendim: Per nje ndryshim ne V.K.B-ne nr .121 date 23.12.2025"Për miratimin e nivelit te pagave te punonjësve te bashkisë Lushnje,institucioneve në vartësi dhe të njesive administrative per vitin 2026".

-Kalohet per shqyrtim <u>pika katermbedhjete</u> e rendit te dites te mbledhjes se Keshillit Bashkiak Lushnje te dates 22.01.2026 : Për një shtesë në buxhetin e vitit 2026,nga te ardhurat e trashëguara ,miratuar me me V.K.B-në nr. 122 datë 23.12.2025.

-Fjala i jepet Juliana Hasalla

-Ne date 30 dhjetor erdhi shkresa nga Ministria e Financave.Kemi perfituar 24 ML leke fonde ,per detyrime te prapambetura .Keto trajtohen si fonde te trasheguara.Kane ardhur ne vitin 2025 por po e paraqesim tani. Fondet do te shkojne te N.P.P-ja.

-Hidhet ne votim ky material.

-Miratohet me 28 vota pro,0 kunder , 0 abstenim .

-Vendim: Për një shtesë në buxhetin e vitit 2026,nga te ardhurat e trashëguara ,miratuar me me V.K.B-në nr. 122 datë 23.12.2025.

-Kalohet ne shqyrtim **pika e pesembedhjete** e rendit te dites te Mbledhjes se Keshillit Bashkiak Lushnje te datet 22.01.2026: Për një shtesë në buxhetin e vitit 2026 nga granti i bazuar në performancë, ,trashëguar nga viti 2025 ,miratuar me V.K.B-në nr. 122 datë 23.12.2025.

-Fjala i jepet kryetares se bashkise.
Keto jane per dy sheshet qe miratuat te pika 5-te.

-Hidhet ne votim ky material

Miratohet me 28 vota pro, 0 kunder, 0 abstenim

-Vendim: Për një shtesë në buxhetin e vitit 2026 nga granti i bazuar në performancë, ,trashëguar nga viti 2025 ,miratuar me V.K.B-në nr. 122 datë 23.12.2025.

-Kalohet ne shqyrtim **pika e gjashtembedhjete** e rendit te dites te Mbledhjes se Keshillit Bashkiak Lushnje te dates 22.01.2026: Për disa ndryshime në V.K.B-në .nr 114 date 21.11.2025"Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore,administrimin e tyre në Bashkine Lushnje dhe penalitetet për kundravajtje administrative.

Fjala i jepet Donald Nushi

Behet fjale per saktesim termash "Termi biznes i madh dhe i vogel "hiqet dhe behet "Nga niveli i xhiros".Ka ndryshim vetem ne emertim.

Fjala i jepet Pirro Kallajxhiu

Propozoj qe demet te zhdemtohen nga ai qe kryen demtimin.Kete e kam pare edhe nga disa bashki te tjera.

Fjala i jepet Erion Bano

Kisha dicka.Pse bllokohen llogarite e qytetareve nese nuk jane paguar taksat**?**

Fjala i jepet Kryetare se bashkise

Ne ndjekim hapat ligjore per kete procedure .Ne fund eshte bllokimi i llogarive .Kjo shkon deri dhe bllokim ne hipoteke.

-Hidhet ne votim ky material .

Miratohet me 2 8 vota pro, 0 kunder, 0 abstenim.4 pa votuar.

-Vendim: Për disa ndryshime në V.K.B-në .nr 114 date 21.11.2025"Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore,administrimin e tyre në Bashkine Lushnje dhe penalitetet për kundravajtje administrative.

-Kalohet ne shqyrtim **pika e shtatembedhjete** e rendit te dites te Mbledhjes se Keshillit Bashkiak Lushnje te dates 22.01.2026: Për miratimin e planit te aktiviteteve të këshillit bashkiak Lushnje per vitin 2026.

Fjala i jepet Kryetare se bashkise

Ne buxhet eshte parashikuar nje fond per mediat.Kush ta fitoje do te pasqyroje aktivitetet e keshillit dhe bashkise
-Hidhet ne votim ky material .

Miratohet me 28 vota pro, 0 kunder, 0 abstenim .

-Vendim: Për miratimin e planit te aktiviteteve të këshillit bashkiak Lushnje per vitin 2026.

Kalohet ne shqyrtim **pika e tetembedhjete** e rendit te dites te Mbledhjes se Keshillit Bashkiak Lushnje te dates 22.01.2026: ” Per miratimin e prishjes se objektit mulli ne fshatin Garunjas Nj Administrative Ballagat Bashkia Lushnje.

-Nuk ka diskutime .

Hidhet ne votim ky material.

Miratohet me 28 vota pro, 0 kunder, 0 abstenim .

-Vendim: Per miratimin e prishjes se objektit mulli ne fshatin Garunjas Nj Administrative Ballagat Bashkia Lushnje

-Kalohet ne shqyrtim **pika e nentembedhjete** e rendit te dites te Mbledhjes se Keshillit Bashkiak Lushnje te dates 22.01.2026: Informacion mbi nxjerrejn jashte perdorimit te aktiveve per vitin 2025.

Nuk ka diskutime .

-Kalohet ne shqyrtim **pika e njezete** e rendit te dites te Mbledhjes se Keshillit Bashkiak Lushnje te dates 22.01.2026.Mbi miratimin e proces verbalit .

Nuk ka diskutime

-Hidhet ne votim .

-Miratohet me 28 vota pro, 0 kunder, 0 abstenim.4 pa votuar.

-Vendim: Mbi miratimin e proces verbalit.